



## **Australian Government**

### **Department of Health**

#### **Mbështetje për ata që janë në pikëllim dhe të traumatizuar nga prekja e COVID-19 në sektorin e kujdesit të të moshuarve**

Qeveria Australiane është duke financuar shërbime për të siguruar mbështetje për ata në pikëllim, që kanë humbur dikë dhe për të traumatizuarit në sektorin Australian për kujdes të të moshuarve. Shërbimet janë në dispozicion për banorët e shtëpive për kujdes të të moshuarve, marrësit e kujdesit në shtëpi, të dashurit e tyre dhe stafi për kujdes të të moshuarve. Ju mund t'i përdorni këto shërbime vetë, ose t'i lejoni të dashurit dhe komunitetet tuaja të dinë rreth tyre.

Ato janë falas për përdorim nga të gjithë.

Të gjitha këto organizata janë respektojnë kulturën, fenë, identitetin dhe mënyrën e jetesës së njerëzve. Nëse ju ose një i dashur i juaj ka nevojë për një përkthyes, telefononi Shërbimin e Përkthimit dhe Interpretimit në **131 450**. Kërkoni gjuhën tuaj dhe shërbimin me të cilin dëshironi të lidheni.

#### **Mbështetja për të pikëlluarit dhe që kanë humbur dikë**

##### **Këshillim telefonik:**

Qendra Australiane për Pikëllim dhe Humbje (të një personi) ndihmon stafin për kujdes të të moshuarve, ofruesit e kujdesit për të moshuarit, grupet fetare dhe të komuniteteve për të mbështetur komunitetet e tyre në pikëllim dhe humbje si pasojë e COVID-19. Telefononi **1800 222 200** për këshilla se si të ndihmoni komunitetin tuaj.

Kur telefononi, mund t'u flisni atyre për atë që ju nevojitet për të mbështetur ju ose të dashurit tuaj. Kjo mund të përfshijë këshillim në grup ose seanca këshillimi të drejtpërdrejt me një mjek nëpërmjet telehealth (me telefon ose nëpërmjet videokonferencës), ose personalisht.

Qendra Australiane për Pikëllim dhe Humbje ka stafin bilingual që punon me klientët në arabisht, çekisht, farsi, frëngjisht, italisht, japonisht, gjuhën malteze, sinhala, tamil, spanjisht dhe jidisht. Kërkoni gjuhën tuaj kur të telefononi. Për gjuhë të tjera, thirrni Shërbimin e Përkthimit dhe Interpretimit së pari në **131 450** dhe kërkoni Qendrën Australiane për Pikëllim dhe Humbje.

Qendra Australiane për Pikëllim dhe Humbje gjithashtu mbështet përdorimin e Auslan (gjuha e shenjave) për njerëz të shurdhër dhe me dëgjim të dëmtuar.

##### **Mbështetja për demencë:**

Mbështetja Australiane për Demencë ofron ndihmë 24-orëshe në të gjithë Australinë, 365 ditë në vit. Ato ofrojnë këshilla dhe rekomandime për njerëzit që kujdesen për dikë me demencë. Telefononi ata në **1800 699 799**. Nëse ju ose një i dashur i juaj ka nevojë për një përkthyes, telefononi Shërbimin e Përkthimit dhe Interpretimit në **131 450** dhe kërkoni Dementia support Australia (Mbështetja për demencë Australi).

**Avokim:**

Rrjeti për avokim të personave të moshuar ofron shërbime për avokim për personat e moshuar nën kujdes në të gjithë Australinë. Nëse keni probleme me shërbimet që merrni për kujdes të të moshurve, ata mund t'ju ndihmojnë. Rrjeti për avokim të personave të moshuar siguron avokim falas, konfidencial, të pavarur, informacione dhe edukim për të moshuarit, familjet dhe përfaqësuesit e tyre. Telefononi ata në **1800 700 600**. Nëse ju ose një i dashur i juaj ka nevojë për përkthyes, telefononi Shërbimin e Përkthimit dhe Interpretimit në numrin **131 450** dhe kërkoni Rrjetin për avokim të personave të moshuar.

**Më shumë informacione rreth COVID-19**

Është e rëndësishme që të jeni të informuar përmes burimeve zyrtare. Vizitoni [health.gov.au](https://www.health.gov.au) ose telefononi Linjën Nacionale për Koronavirus në **1800 020 080**. Për shërbime përkthimi dhe interpretimi telefononi **131 450** dhe kërkoni Linjën Nacionale për Ndihmë për Koronavirus.